

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**DEGA: GJUHË SHQIPE**



**PUNIM DIPLOME**

**DUKURI ME VLERA ETNOLINGUISTIKE NË PROZËN E ERNEST KOLIQT NË HIJA E  
MALEVE DHE TREGTAR FLAMUJSH**

**MENTORJA:**

**Dr.Rovena Vata**

**KANDIDATI:**

**Muradije Duraj**

**Gjakovë, 2017**

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**DEGA: GJUHË SHQIPE**



**PUNIM DIPLOME**

**DUKURI ME VLERA ETNOLINGUISTIKE NË PROZËN E ERNEST KOLIQIT NË HIJA E  
MALEVË DHE TREGTAR FLAMUJSH**

Komisioni:

Kryetar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

**MENTORJA:**

Dr. Rovená Vata

**KANDIDATI:**

Muradije Duraj

Gjakovë, 2017

# PASQYRA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>4</b>
1.Objekti dhe motivimi i temës.....	4
2.Metodologjia dhe metodat e punës .....	5
3.Baza teorike e punimit .....	6
4.Synimi i temës.....	6
<b>KREU I: ERNEST KOLIQI</b> .....	<b>8</b>
1.1 Jeta dhe krijimtaria .....	8
1.2 Novelat <i>Hija e maleve</i> dhe <i>Tregtar flamujsh</i> .....	10
<b>KREU II: DUKURI ME VLERA ETNOLINGUISTIKE NË VEPRËN E KOLIQIT</b> .....	<b>15</b>
2.1 Raportet e farefisnisë.....	15
2.2 Fjalët përkëdhelëse .....	17
2.3 Pritja dhe respekti ndaj mikut .....	18
2.4 Miqësia (hatri i miqësisë së vjetër) .....	19
2.5 Përsëndetjet .....	20
2.6 Fejesa (shkuesia) .....	22
2.7 Vdekja .....	24
2.8 Elementet fetare.....	29
2.9 Urimet për ditën e emrit .....	31
<b>PËRFUNDIME:</b> .....	<b>33</b>
<b>BIBLIOGRAFIA:</b> .....	<b>36</b>

# HYRJJE

## 1. Objekti dhe motivimi i temës

Ernest Koliqi bën pjesë në radhën e personaliteteve më të rëndësishme të kulturës dhe historisë shqiptare. Përmes veprave që kemi marrë në analizë si *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*, mund të themi se Ernest Koliqi është një njohës i mirë i psikikës njerëzore, një njohës më se i mirë i traditave dhe zakoneve shqiptare. Ernest Koliqi me gjithë trashëgiminë e tij krijuese, zë një vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë dhe të kulturës shqiptare.

Ernest Koliqi, intelektual i shquar, poet, prozator<sup>1</sup>, përkthyes, studiues, profesor universiteti, zë një vend të rëndësishëm edhe në historinë e arsimit shqiptar.

Kontributi i tij në arsim merr peshë historike, sidomos për “viset shqiptare të lirueme”, ku për herë të parë u organizuar arsimit shqip në permasa aq të mëdha dhe në kuadër të një sistemi unik të arsimit kombëtar<sup>2</sup>.

Në studimet e tij shkrimtari Ernest Koliqi e vështron letërsinë në rrjedhat e saj të zhvillimit historik si një nga manifestimet më të fuqishme të shpirtit shqiptar, duke ruajtur atë koherencë të brendshme, që shquhen punimet e tij nga fillimi deri në fund<sup>3</sup>.

Dëshmitë pasionante të punës së Ernest Koliqit në fushën e arsimit shqiptar jepen përmes përmbajtjes dhe kontributeve konkrete që ai sjell me veprat e tij. Në kulturën dhe inteligjencën profesionale që e karakterizon Koliqin vihet robërisht në shërbim të punës për të ingranuar sipas mundësive kulturën tonë me nivelet e kohës nëpërmjet krijimeve origjinale, përkthimeve, botimeve, reformave arsimore. Vizioni i tij për kulturën shqiptare, për gjuhën e letërsisë tonë, e në veçanti për të ardhmen e arsimit, është themelisht i qartë e me prespektivë. I lindur në një ambient katolik shkodran, në kontakt që herët me kulturën perëndimore, Ernest Koliqi nuk e intereson vetëm letërsia e huaj e sidomos ajo italiane me të

---

<sup>1</sup> Anton Nikë Berisha, *Koliqi dhe prozator*, Toena, Tiranë, 1997.

<sup>2</sup> Hajrullah Koliqi, *Ernest Koliqi-ministër i arsimit kombëtar në Shqipërinë “Ethnike”*, në: Malësia, nr. 7, revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore, Podgoricë, 2012, f. 67.

<sup>3</sup> At Zef Valentini, *Ernesti pasqyrë e kalimit njerëzor*, në: “Studime Shqiptare”, nr. 3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995, f.78.

cilën u formua. Atë e tërheqin gjithmonë vlerat e vërteta të artit tonë tradicional. Kjo i jep personalitetit të tij një peshë të veçantë<sup>4</sup> dhe kuptimplotë sin ë studime letrare apo në studime gjuhësore.

Studimet në fushën e gjuhësisë dhe sidomos në atë psikolinguistike në ditët e sotme po vijnë e po bëhen objekt studimi. Në këtë punim diplome kemi marrë si rast studimi personalitetin e letrave shqipe, shkrimtarin e mirënjohur Ernest Koliqin. Krijimtaria e tij është e shumëllojshme, por ka qenë e ndaluar politikisht dhe ideologjikisht për rreth 50 vjet, prandaj asaj për një kohë të gjatë i ka munguar lexuesi e receptuesi shqiptar i lejuar në Republikën e Shqipërisë. Kurse në Kosovë nuk ishte e njëjta gjendje, atje vepra e tij lejohej të lexohej e të studiohej.

Ernest Koliqi është krijues i shumë planeve, i krahasueshëm me disa të paktë personalitete në kulturën shqiptare, Ernest Koliqi ka një krijimtari të pasur. Një gjysmë shekulli zgjati krijimtaria e tij letrare dhe po kaq zgjati edhe kontributi i tij në fushën e mendimit letrar, kohë relativisht jo e shkurtër në jetën e një individi. Ai erdhi në letërsinë dhe kulturën tonë shqiptare në fillim të viteve '20, për të mos u shkëputur për asnjë çast prej tyre deri në fund të jetës së tij dhe, nisur vetëm nga kjo, mund të merret lehtë me mend se kontributet e tij nuk janë të zakonata. Ai erdhi në letërsinë shqipe një koncept të ri e të plotësuar, refleksi i një vetëdije të qartë, me një përkushtim të tillë që shpërfaqej fuqishëm në disa fusha krijimi, si në atë të krijimeve të mirëfillta letrare, të përkthimeve dhe në mendimin letrar shqiptar<sup>5</sup>.

Gjuha e veprës së Ernest Koliqit është e veçantë. Kjo duket në tregimet e shkurtra, në tregimet e gjata, në dramën e shkruara prej tij, në poezitë apo në përkthimet me një cilësi të jashtëzakonshme. S'ka rrafsh gjuhësor në këto vepra, ku ai të mos e tregojë talentin, zotësinë dhe mjeshtërinë, që dallon nga shumë krijues të tjerë dhe që i krijojnë origjinalitetin e veprës dhe të krijimtarisë së Ernest Koliqit.

## **2. Metodologjia dhe metodat e punës**

Për të realizuar këtë punim diplome kemi përdorur metodën krahasuese, për të nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe dallimet mes novelës *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*. Po përmes kësaj metode në do marrim në analizë elementet letrare të analizuara përmes studimit gjuhësor.

---

<sup>4</sup> Eli Karamitri, *Ernest Koliqi dhe arsimiti shqiptar*, në: "Studime Shqiptare", nr. 3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995, f. 81.

<sup>5</sup> Fatbardha Hoxha, *Vështrim mbi mendimin letrar të Ernest Koliqit*, në: "Studime për autorë të ndaluar", Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2008, f. 114.

### 3. Baza teorike e punimit

Për të trajtuar lëndën e krijuar nga Ernest Koliqi nga ana gjuhësore na duhet një sërë njohurish, qoftë nga ana letrare apo nga ajo gjuhësore. Për t'i dhënë formën e merituar këtij punimi kemi përdorur si lëndë të parë veprat artistike të autorit në fjalë, por për t'i dhënë një formë edhe sa më shekncore punimit, kemi përdorur literaturë të pasur që kanë botuar ndër vite, për krijimtarinë e këtij autori.

### 4. Synimi i temës

Veprimtaria e Ernest Koliqit njih një shumësi vlerash që i solli letërsisë shqipe. Çështjet që ai trajtoi ishin kryeshit ato që kishin të bënin me vendlindjen e tij, Shqipërinë. Traditat e shqiptarëve zënë vend në veprat e tij artistike, duke e bërë autorin njohës e interpretues të rrallë të vlerave entolinguistike të popullit shqiptar.

Gjuha e ka shoqëruar njeriun gjatë gjithë rrugëtimit të tij në shekuj. Bashkë me funksionin kryesor, atë të komunikimit, ajo ëhstë bërë dëshmitare ngjarjesh, etapash nëpër të cilat ka kaluar ajo bashkësi gjuhësore, duke regjistruar edhe mjaft elemente të tjera që lidhen me kulturën, traditën e një shoqërie të caktuar<sup>6</sup>.

Në esetë e tij me karakter, Koliqi do t'i mëshojë fort argumentit të tij të preferuar se populli shqiptar që lëshoi rrënjë para mijëra vjetësh në një truall ku u ndeshën dhe u përplasën kultura të ndyrshme, ruajti përballë tallazeve tiparet themelore individuale si komb. Në themel të qendresës dhe të mbijetesës së tij përkundër dyndjeve shekullore qëndron nënshtresa e lashtë pagane e fisit si dhe mendësia kanunore shqiptare. Ndikimet e kulturave të ndyrshme u përplasën dhe u thyen taman në këtë nënshtresë autoktone që ruajti të pacënuar tipare të papërsëritshme të arbërve<sup>7</sup>.

Rast tipik kemi novelat *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*. Të dy përmbledhjet përmbajnë ngjarje të shkëputura nga shoqëria shqiptare e shekullit të kaluar, një shoqëri që jetonte me ligjet e pashkruara të kanunit, që ishin të vjetra po aq sa malet e larta të Shqipërisë.

---

<sup>6</sup> Mimoza Priku, *Gjuha dhe kultura në vështrim etnolinguistik*, në: "Malësia", nr. 7, revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore, Podgoricë, 2012, f. 183.

<sup>7</sup> At Zef Valentini, *Ernesti pasqyrë e kalimit njerëzor*, në: "Studime Shqiptare", nr. 3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995, f. 78.

Tema përmban këto dukuri etnolinguistike: raportet farefisnore, fjalët përkëdhelëse, pritja dhe respekti ndaj mikut, përshëndetjet, miqësia (hatri i miqësisë së vjetër), fejesa, vdekja, elementet fetare dhe urimet për ditën e emrit.

Njëra çështje nxjerr tjetrën. Ato renditen njëra pas tjetrës si hallka zinxhirësh, që në fund formojnë rendin e përbashkët të një shoqërie.

Më këtë punim synojmë të nxjerrim në pah kontributin e Ernest Koliqit për mbrojtjen e traditave shqiptare, zakoneve, dokeve dhe riteve.

## KREU I: ERNEST KOLIQI

### 1.1 Jeta dhe krijimtaria

Ernest Koliqi lindi në Shkodër më 20 maj të vitit 1903, në një familje të madhe tregtare dhe patriotike me origjinë nga Shiroka.

Koliqi është një ndër shkrimtarët më të shquar të kulturës dhe të letërsisë shqiptare të shekullit të kaluar. Njihet si shkrimtar, përkthyes, publicist dhe politikan. Ernest Koliqi u shkollua në Itali, ku diplomoi në Universitetin e Padovës me tezën “Epika popullore shqiptare”.

Me vlerat e veta letrare shumëzhanore dhe me tërë trashëgiminë e tij si krijues, Ernest Koliqi zë një vend të merituar në historinë e kulturës sonë kombëtare. Krahas ndihmesës së tij në fushën e publicistikës e të arsimit, profili i tij krijues na shfaqet në disa rrafshë si: poet, prozator, përkthyes, kritik e studiues i letërsisë dhe në shumë prej tyre ai la gjurmë të pashlyeshme me forcën e talentit të tij të rrallë.

Ai do ta fillojë si poet rrugën e gjatë krijuese që do të përshkojë. Dhe jo rastësisht do ta fillojë atë me “Kushrimin e Skenderbegut”, poemth dramatik, që u botua në mesin e viteve ‘20 vite të mbushura me intensitet ngjarjesh, kur shteti shqiptar e shoqëria shqiptare kërkonte, që përmes emancipimit të afirmojë identitetin e saj. Ky krijim i parë i botuar i Ernest Koliqit që ka vlerën e një shkrimtari me tone epike pasohet nga vëllimi “Gjurmët e Stinëvet”, 1933 dhe poemthi “Sinfonia e Shqipeve”, 1935 dhe krijimi i poetik pothuajse mbyllet me “Kangjelet e Rilindjes”, që merr kuptimin e një finaleje optimiste me një kuptim të disafishtë. Krahas toneve epike në krijimtarinë poetike të Ernest Koliqit do të shfaqeshin edhe tone delikate që do të flisnin për një poet të ndjenjës dhe shijës së hollë<sup>8</sup>.

I ndjeshëm është kontributi i Koliqit në hatimin e teksteve që botohen në vitet ‘40: “Rreze drite”, “Te praku i jetës”, “Bota shqiptare”, që dhe me tekstin dvëllimësh me gati 1000 faqe “Shkrimtare shqiptare” që, jo vetëm pas teksteve të Justin Rrotës dhe Eqrem Çabejt, por krahasuar edhe me tekstet të mëvonshme, përbën një kontribut të shënuar në llojin e vet. Në revisten “Shejzat”, më 1972, Koliqi do të

---

<sup>8</sup> Fatbardha Hoxha, *Rreth kontributit të Ernest Koliqit si studiues i letërsisë*, në: “Studime Shqiptare”, nr.3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995, f. 73.



pohonte se këto tekste u botuan “nën kujdesin tim të drejtpërdrejtë”. Se çfarë vlere përmban teksti “Shkrimtare shqiptare” e jep edhe ky fakt që po përmendim lidhur me faktet që iu dhanë autorëve shqiptarë të traditës: Buzukut 11 faqe, Budit 15 faqe, Bardhi 6 faqe, Bogdanit 22 faqe, De Radës 27 faqe, Naimit 34 faqe, Fishtës 44 faqe, Fan Nolit 21 faqe, Kristoforidhit 23 faqe, Konicës 15 faqe, Ndoc Nikaj 19 faqe. Ndonëse libri nuk është edhe pa ndonjë mungesë që e shpjegon koha, ai është ndër më të mirët e llojit për saktësinë e gjërësinë e informacionit dhe mënyrën e parashtrimit të tij.

Kontributi i Koliqit në fushën e kritikës letrare dhe të historisë letërsisë është i lidhur me emrin si titullar i katedres së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Romë, me themelimin e Institutit të Studimeve Shqiptare, 1940 në Tiranë, dhe shndërrimin e katedrës së gjuhës dhe të letërsisë në Institutin e Studimeve Shqiptare në Romë. Më 1953 Ernest Koliqi do të botojë në Romë studimin “Dy shkollat letrare Shkodrane”, që veç problemit të diskutueshëm të pranisë së dy shkollave letrare sjell një lëndë me interes për të njohur zhvillimet letrare në Shkodër në shek. 20.

Më tej do të shpreh një interesim të spikatur për vlerat origjinale të traditës letrare shqiptare dhe për t’i dhënë asaj publicitet, jo vetëm në Itali, por edhe më gjerë në Europë. Veprimtaria e tij përkushtuar si pedagog i profesorit i klasit të parë, meritat dhe ekzigjenca e tij shkencore është e lidhur me revistën “Shejzat”, që ai themeloi dhe drejtoi për 18 vjet rresht, revistë kulturore letrare e shoqërore. Në faqet e revistës me një densitet të habitshëm dokumentohet kontributi i gjerë i Koliqit në fushën e kritikës dhe të mendimit historiko-letrar. Rubrikat e saj të vazhdueshme si “Shkoqitje e pleqnime”, “Fjala qet fjalën”, mbahen vetëm në sajë të pasurisë kulturore të këtij personaliteti që zbulon vetveten, jo vetëm si letrar, por edhe si njohës i historisë, etnologjisë dhe psikologjisë sonë kombëtare. Në të njëjtën kohë Koliqi publikon vlerat letrare shqiptare në konferenca që organizon në Itali dhe Europë, përkthen vlera të epikës popullore dhe të lirikës sonë të kultivuar në italisht, të cilat i shoqëron me parathënie interesante<sup>9</sup>.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht gjatë viteve 1941-1942, ishte ministër i arsimit në Shqipëri, i cili kontributin më të madh e dha atë herë kur dërgoi në Kosovë dyqind mësues shqiptarë të ngarkuar me libra, të cilët do të ndihmonin në hapjen e shkollave shqipe. Koliqi i dha një ndihmesë arsimit shqip edhe me botimin e teksteve shkollore, sidomos ato nga fusha e folklorit. Në fushën e arsimit Koliqi meriton një vëmendje të veçantë.

---

<sup>9</sup> At Zef Valentini, *Ernesti pasqyrë e kalimit njerëzor*, në: “Studime Shqiptare”, nr.3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995, f.75-77.

Por, mbi të gjitha, me bashkimin e Kosovës u bë një punë e madhe serioze, duke themeluar e dule lulëzuar një rrjetë të gjerë e të dendur shkollash në gjuhën shqipe, ku përpara nuk ekzistonte si në shuplakë të dorës që arriti kultura shqiptare në regjione, ju zmbarsen Jugosllavisë më 1945, me ogur të Rusisë<sup>10</sup>.

Gjatë viteve 1930-1933 i kushtohet problemeve të arsimit, duke punuar si mësues në Vlorë e në Shkodër. Më 1938-en fillon punën si profesor i gjuhës e i letërsisë shqipe në Universitetin e Padovës, kurse më 1939-en emërohet profesor i gjuhës e letërsisë shqipe në Universitetin e Romës e pak muaj më vonë bëhet Ministër Arsimit i Qeverisë shqiptare. Gjatë kësaj periudhe njihet si nismëtar i mjaft reformave arsimore dhe është përgjegjës për botimin e mjaft teksteve që zunë vend në programet e shkollave fillore dhe të mesme.

Në vitin 1941-1942 është nismëtar i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë, duke dërguar 200 mësues e mësuese nga Shqipëria. 12 dhjetori 1941 njihet si datë e shënuar e hapjes së shkollës së parë të mesme në gjuhën shqipe në Kosovë.

Ishte themeluar dhe drejtues i tri revistave kulturore: “Ora e maleve”, “Shkëndija” dhe “Shejzat”. Ernest Koliqi ushtroi edhe profesionin e mësuesit dhe profesorit më shumë se tridhjetë vjet në Padovë dhe Romë të Italisë. Për një kohë iu ndalua vepra e tij, jo për shkak të përmbajtjes së saj, por për pozitën e Koliqit si ministër në atë kohë. Veprat e tij më të njohura janë: *Kushtrimi i Skanderbegut*, *Hija e maleve*, *Tregtar flamujsh*, *Pasqyrat e Narçizit*, *Kangjelat e Rilindjes*, *Gjurmat e stinve*, *Symfonia e shqipevet* etj. Pas një kontributi të madh për çështjen e kulturës dhe gjuhës së shqiptarëve, dha frymën e fundit në Romë më 1975. Vdiq me mall për mëmë Shqipërinë.

## **1.2 Novelat *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh***

Në librin *Hija e maleve* Koliqi trajton tema që kanë rrënjë në moralin e Malësisë dhe që tragjicitetin e vet e provojnë sin ë mesin autentik ashtu dhe në ndeshjen e tij me mjedisin qytetar. Këtu zë fill jeta në përjetësinë e saj dhe në zjarminë e saj të ndërrimeve. Toni i përgjithshëm është autentik-tragjik. Kurse në librin *Tregtar flamujsh* trajtohet më shumë jeta e qytetit të Shkodrës, shpalohe mentaliteti i vendit, një harmoni e jetës autentike e cila merr shqetësime dhe me ambiciet e ndryshme, që zbulojnë

---

<sup>10</sup> At Zef Valentini, *Ernesti pasqyrë e kalimit njerëzor*, në: “Studime Shqiptare”, nr.3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995, f. 12.

karakteret, zbulojnë kamjet e skamjet. Teksti bashkë me një qëndrim autorial merr një ton të hollë humori therrës, që nuk ngjitet në nivel të tragjikes<sup>11</sup>.

Tregimet e vëllimit “Tregtar flamujsh” radhiten nga shumë ndër më të mirët e prozës shqiptare të paraluftës<sup>12</sup>.

Personaliteti i Ernest Koliqit, i njërit prej figurave më në zë në kulturën tonë kombëtare, ka shumë komponente të spikatura. Ai vlerësohet si shkrimtar (si themelues i prozës moderne shqipe, si poet, romancier, dramaturg), ai vlerësohet si eseist, përkthyes, gazetar, si mbledhës dhe studiues i palodhur të folklorit. Por vepra e tij ka dhe një komponent tjetër, atë gjuhësor që nuk qëndron poshte të parave, për të cilën, edhe pse është shkruar e folur nga studiues të ndryshëm, do të duhej shumë hapësirë dhe kohë për ta ndriçuar plotësisht<sup>13</sup>.

Koliqi është cilësuar si një ndër prozatorët e mëdhenj. Hija e maleve vëllimin e parë në prozë Koliqi e botoi më 1929 në Zarë. Kjo përmbledhje e novelash zgjoi interes si te publiku ashtu edhe në shtyp, ku gjallonte mendimi i kritik i kohës. Te “Hija e maleve” vihet re ndikimi.

Krijimtaria e Koliqit është e gjithanshme. Filloi me poezi, pastaj vazhdoi me krijime në prozë, që e vunë në pah talentin e shkrimtarit shkodran.

Koliqi është i njohur më shumë me shkrimet në prozë, duke u bërë themeluesi i prozës moderne shqipe në të gjitha aspektet tematike e stilistike. Kulmin letrar e ka arritur me dy përmbledhjet e tij me novela: *Hija e maleve dhe Tregtar flamujsh*.

Në librin e parë trajtohet tema mbi traditat e zakonet e Malësisë, tragjiciteti që shfaqet si shkak i ndeshjes së mesit autentik me mesin modern, qytetar.

Në librin e dytë kemi të paraqitur jetën në qytetin e Shkodrës, mentalitetin e vendit, karakteret e vendasve, pasurinë materiale e shpirtërore etj.

*Shfytëzimi dhe bartja e poetikës së letërsisë gojore, duke ruajtur gjithnjë karakterin afirmativ-sipas invercionit të periudhës së romantizmit, - është një prej veçorive të prozës tregimtare të Ernest Koliqit<sup>14</sup>.*

---

<sup>11</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000, f. 113.

<sup>12</sup> Robert Elsie, *Letërsia shqipe*, Tiranë, 2006, f. 147.

<sup>13</sup> Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe II*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2015, f. 165.

<sup>14</sup> Arben Hoxha, *Poetika e prozës së Ernest Koliqit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005, f. 42.

Letërsia gojore haset në disa nga novelat e Koliqit. Kjo e bën veprën e Koliqit të jetë e lidhur me rrënjët e kulturës shqiptare, që e shpalos detajisht në secilën temë.

*Hija e maleve* shtjellon jetën e shqiptarëve të paraqitur në dy këndvështrime: jeta e dikurshme me tradita e zakone dhe jeta e re me thyerjen e tabuve, ku bie ndesh tradicionalia dhe modernia. *Përmbledhja Hija e maleve cilësohet me natyrshmëri e vërtetësi të rrëfimit artistik. Ndonëse më pak autobiografike se tregimi i Migjenit "Studenti në shtëpi", këto rrëfenja janë pasqyrim i intelektualëve shkodranë që kishin studiuar jashtë në vitet njëzet e tridhjetë dhe më pas u kthyen në trevën e ashpër të shqiptarëve veriorë*<sup>15</sup>.

Trajtohen virtytet që e kanë karakterizuar popullin gjatë shekujve, ato gjëra që e kanë mbajtur të fortë përballë çdo stuhie të jetës, të ndershëm, të pathyeshëm. Koliqi dukshëm mbron traditën shqiptare kundrejt elemeteve të huaja dhe dëshira e tij ishte të rindërtohen vlerat, të përdoren, ndërsa për t'u eliminuar duhej veç dukuritë negative.

Novela *Gjaku* e librit *Hija e maleve* është vepra më e ndëlikuar në prozë e Ernest Koliqit. Në të është derdhur mjeshtëria e tij e shkrimit, ashtu si janë shprehur pikëpamjet themelore mbo botën shqiptare duke ndërtuar personalitetin e personazhit kryesor të veprës. Në këtë vepër shfaqen idetë për transformimin e kësaj jete, ashtu si dhe pengesat e pakalueshme për këtë transformim.

Përmbi zhvillimet dramatike në jetën e personazhit Doda, ndërmjet programit ndricues të shoqërisë shqiptare dhe atij fundi të shpirtit të tij, është thurur e gjithë vepra *Gjaku*. Në këtë vështrim vepra është dhe një studim i thellë psikologjik i Dodës.

Mësuesi i ri Doda është me origjinë malësor, po që ka kryer mësimet e larta dhe jashtë shtetit. Duke qenë i tillë, që edukon breza të rinj me dije, ai mendon që shoqëria ndryshon nëpërmjet arsimit, e arsimi bëhet nëpërmjet librit, kulturës e dijes.

Doda, protagonist mësues, ka marrë dije e ide të reja, mirëpo në thellësitë e tij shpirtërore rri një kulturë jetësore e ambientit e cila fle, por zgjohet nëse preket në themelet e saj. Ky tregim i Koliqit, i cili shtron çështjen e ndeshjes të projektit të ndricimit kulturor me realitetet e thella shpirtërore. Këto ndeshen dhe fiton shtresimi i moçëm, që do të thotë se ai s'është vetëm obligim kaunor, po një qenësi me strukturë psikologjike.

---

<sup>15</sup> Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, përkthyes: Abdurrahim Myftiu, Dukagjini, Botimi i dytë, Pejë, 2001, f. 332.

Një variant tjetër i raportit të jetës në Malësi e në Shkodër del te novela *Diloca*, që është shkruar në trajtë të dëshmisë e të ditarit, e thurur në 15 pjesë, që nis më 17 janar dhe mbaron më 10 prill. Tregimi është ndërtuar mjeshtërisht në dy nivele. Në njëren anë duke u përpjekur për të zgjidhur enigmën, e në anën tjetër duke lidhur një enigmë të re. kështu duke zbuluar enigmën e ngjarjes së mëparshme, vepra në të vërtetë zbulon shpirtin e rrëfimitarit (autori).

Në tregimin *Kërcimtarja e Dukagjinit* e cila është në mes të përrallës e të legjendës. *Mbesa e Lekë Dukagjinit*, një vajzë e bukur e hyjnore, po një përtase sat a mbulojë me brengë familjen e fisin<sup>16</sup>.

Koliqi me *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh* bëhet prozatori më i madh i letërsisë moderne, gjeni në artin e të rrëfyerit dhe të ndërtimit të karaktereve të personazheve. Me këto vepra dëshmohet zhdërvjelltësia e tij në pendë.

Përmbledhja e dytë *Tregtar flamujsh* trajton temat sociale të Shqipërisë të asaj kohe. Brenda saj përballemi me personazhe që dalin lakmitarë, intrigantë, përbuzës, por edhe ëndërrimtarë, të ndjeshëm, plot shpresë.

Te tregimet e librit *Tregtar flamujsh* jeta shkodrane paraqitet me realitetin e vet të ashpër, duke zbuluar botën e fshehur të ambicieve të njerëzve, shpirtin e celur po edhe shpirtin e mykur që përkundet në errësime të së kaluarës.

Një ndiesi e errët, si një neveri e paspjegueshme mbante Hilush Vilzën nga dugâja e Gaspër Tragaçit. Kështu fillon tregimi *Tregtar flamujsh*, duke i vënë ballëpërballë dy personazhet që i afron jeta e qytetit, por i largojnë idetë. I gjithë tregimi është një shtjellim i tonit që jep fraza e parë. Hilush Vilza është vetë autori, një vjershetar, kurse Gaspëri është tregtar dhe i njohur i familjes. Mospërlqimi i tyre ndodhet jo në jetët e dy brezave, po në botëkuptimin. I pari fantazon të bukurën, i dyti ngjitet për realen, e pra që të dy domosdo jeta i shpie kah bisedat për Shqipërinë. Tregtari ngre teorinë se i lirë është ai që nuk ka nevojë për tjetrin, kurse poeti mendon se ushqimi shpirtëror është për të gjithë. Tregtari mendon se poezia nuk ka kuptim nëse nuk është e dobishme, për aq sa të shitet malli i tij<sup>17</sup>.

Titulli i tregimit *Bylbylat e Plepishtit* është një metaforë zbuluese e dashurisë. Tre personazhet e tregimit: Hilushi, Loro e Ciljeta, nuk arrijnë të bëhen protagonist të dashurisë, ata vetëm sa arrijnë të shqiptojnë mentalitetet e ndryshme dhe paragjikimet për dashurinë. Koliqi në këtë tregim ngre çështjen

---

<sup>16</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000, f. 116-117.

<sup>17</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000, f. 117.

e paragjykimit që është mosnjohje, mandej turbullimën që sjell kultura e huaj pa u njohur thellë kultura e vendit. Atëherë kur dashuria, a pëlqimi e ndrit horizontin e të menduarit, gjithnjë ëhstë vonë. Në thelb, autori tall një mentalitet të shartuar për të ngrhur kultin e bukurisë, dashurisë e mençurisë vendëse.

Një raport të llojit të veçantë ndërmjet malësorit e njeriut të qytetit, apo të Malësisë e të Shkodrës, Koliqi e ka krijuar në novelën Djepi arit. Malësori Bajram, me tregimin e vet për pasurinë e gjetur nën dhé, trondit gjithë qytetin dhe ambiciet e tij. Ai më në fund trondit edhe shkrimtarin Hilush edhe tregtarin Loro, me të njëjtën fuqi. Tregimi i Malësorit është një shtypës për zbulimin e botës së brendshme të ndrydhur të personazheve, që paraqesin shtresat qytetare.

Bajrami tregimin e sht kudo, merr të hollat e para, dhe sekush e përpin këtë tregim me kusht që most a dijë tjetri. Mandej secili duke përkundur ambicien në fantazinë e vet krijon ëndërrën për pasurinë e gjetur e të pafiturar. Po, njëherësh shpalon botën e vet të ëndrrës, njësoj si karakterin e vet.

Dijatari Hilush Vilza me pasurinë e fituar do të krijojë muzeume arkeologjike, do të argumentojë teorinë ilire apo do të ndërtojë institute të dijes shqiptare. Tregtari Loro do të krijojë pasuri, me qarkullime të mëdha brenda dhe jashtë shtetit. Sekush e përkund ëndërrën e vet në djepin e arit të tregimit të malësorit, djep që rri në dhé i fshehur dhe i paparë kurrë<sup>18</sup>.

*Mendimi i Ernest Koliqit se “letërsia asht pasqyra e shpirtit të një populli”, është mendimi i fuqishëm me domethënie letrare e historike që rrezaton edhe në kohën e sotme<sup>19</sup>.*

---

<sup>18</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000, f. 119.

<sup>19</sup> Sali Bashota, *Domethënia e ideve letrare*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f. 198.

## KREU II: DUKURI ME VLERA ETNOLINGUISTIKE NË VEPRËN E KOLIQIT

### 2.1 Raportet e farefnisnë

Farefnisnë është grupi i njerëzve që kanë lidhje gjaku. Këtu i kemi përfshirë pra njerëzit e familjes e më gjerë. Kjo tërësi njerëzish ruan të njëjtat gjëra si kulturën e zakonet. Familja është bashkësia e disa anëtarëve, që dikur përbëhej nga një numër i madh anëtarësh. Sot ndryshon puna, sepse është zvogëluar numri i njerëzve, që jetojnë në bashkësi.

Burimet e pasurisë leksikore të veprës së Ernest Koliqit janë:

**Burimi i parë** është gjuha e vendlindjes, e folmja e Shkodrës dhe kur ishte në Itali, të folmet arbëreshe. Ernest Koliqi më 1931 shkruan: Gjuha e jonë burimin e vet të pashtershëm e ka në popull. Fjalë, thanje janë mbledh mjaft, gjithnjë mblidhen, prap të tjera do të gjinden qi do të hyjnë në përdorim ma vonë. Por nuk flas për këtë studim makinal, i cili asht i detyrueshëm për çdo Shqiptar. Randësi shumë ma të madhe ka studimi i atij ritmi të çuditshëm qi merr gjuha e jonë në gojë të popullit, kuptimi i saj muzike qi jehon në fjalët e njerëzve të paprishur nga letërsitë e hueja. Kur flasin njerëzit pa shkrim e pa këndim, një melodi e pazaptueshme rrëshqet në rreshtimin e fjalëve të tyne; thanja u del e njomë, fjalija ka lakime mrekullisht të bukura e të zhdërvjellëta, lidhjet janë mjeshtërore e të natyrshme. At melodi, ato karakteristika duhet të përpiqemi me shti në stil t'onë për në daçim me shpesh ma s'miri ndiesit e thella qi msheh shpirti i kombit.

Të komunikosh nuk do të thotë vetëm të marrësh e të japësh informacione, por të hysh në marrëdhënie me të tjerët, të krijosh një imazh për rta dhe për veten. Rreth këtij koncepti janë bërë mjaft përkufizime e interpretime të ndyshme, nisur nga disiplina, si: *pragmatica*, *sociolinguistica*, *etnografia* e të folurit etj<sup>20</sup>.

**Burimi i dytë** është folklori, gjuha e krijimeve popullore si gojëdhënat, këngët, përrallat, eposi i kreshnikëve etj, rreth të cilave bëri studime dhe mbrojti tezën e doktoraturës.

**Burimi i tretë** është gjuha e trashëgimisë së kulturës italiane e botërore. Ernest Koliqi, qysh herët, kur shkollohej në Itali, u njoh me një kulturë të gjerë sidomos latino-italiane, prej së cilës mori e dha. Ai vlerësohet si përkthyesi më kompetent që kemi pasur nga italishtja e frëngjishtja në shqip, sikurse nga shqipja në italishte. Ernest Koliqi i pari që përballoi përkthimin e poetëve të mëdhenj, si: Dante Aligheri,

---

<sup>20</sup> Mimoza Priku, *Gjuha dhe kultura në vështrim etnolinguistik*, në: „Malësia“, nr. 7, revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore, Podgoricë, 2012, f. 183.

Perarca, Aristo Tasso, Foscolo, Carducci, Pascoli, D'Annuzio, Baudlaire, Maeterlinck, Verhaeren etj. Në këtë përballje, me punën e vetë të jashtëzakonshme, ai nxori në pah dhe rriti funksionin informues e shprehës, veprues e ndikues të fjalës shqipe e të vetë gjuhës shqipe<sup>21</sup>.

Në novelat e Koliqit hasim shumë aspekte etnolinguistike, që vënë në pah kulturën shpirtërore e materiale të popullit shqiptar. Raportet e farefisnisë, konkretisht në mes të anëtarëve të një familjeje, studiohen në bazë të lidhjes që kanë secila mes vete afërsinë a largësinë. Dikur, se sot jo, tek shqiptarët sundonte burri si zot i vetëm shtëpie, do me thënë mbizotëronte sistemi patriarkal.

Duke i vështuar me kujdes këto novela të Koliqit shohim se janë përdorur këto emërtime të farefisnisë: për babain gjejmë: bâba, tatë, apë, por e gjejmë edhe me prapashtesën e përkëdhelisë (–ush thuej babushit tand)<sup>22</sup>.

Gruaja nuk përzihej në punët e burrit, nuk gëzonte lirinë e fjalës e as lirinë e të dalurit. Aq ishte i parëndësishëm imazhi i femrës, sa asaj i ndalohej ta thërriste në emër bashkëshortin e saj e i mohoheshin shumë gjëra të tjera. E njëjta ndodh anasjelltas.

Burri i drejtohet gruas me ndonjë fjalë si: *e shoqja, gruaja* etj. Me përjashtim burri mund ta thërrasë gruan e tij edhe në emër ose të paktën të ia përmend emrin.

Kemi te novela *Ândërr e një nji mbasditje vere* te *Hija e maleve*, ku i ati i thotë vajzës:

*“-Un s’mund të përcjelli, pse kam punë. Çilja s’din me shkue vetëm as deri te Ura e Drinit”*<sup>23</sup>.

Kemi rastin kur autori e përdor fjalën *e shoqja* për gruan e personazhit të novelës *A ta laçë* te *Tregtar flamujsh*, Shan Arvenit:

*“-Mos is nisë tashti me filozofinë tande! ia këputi fjalën në gojë Tonja, e shoqja”*<sup>24</sup>.

ose:

*“-Mbandej ndezi edhe ai cigaren, u shti në bar, tue i thënë së shoqes...”*<sup>25</sup>.

Një rast i veçantë kur gruaja i drejtohet burrit të saj është *nieri*, që edhe sot mund të dëgjohet në zonat rurale. Koliqi këtë fjalë e përdor në novelën *Anmiku në shtëpi* te *Tregtar flamujsh*:

*“-Shak ke, more nieri?”*<sup>26</sup>.

Kemi raportin prindër-fëmijë dhe fëmijë-prindër. Vajza apo djali në disa prej novelave të Koliqit i drejtohet nënës: *nanë, loke, dadë*. Te novela *Nusja e mrekuullueshme* Lekë Binaku i drejtohet nënës:

<sup>21</sup> Ernest Koliqi, *Vepra 2*, Konica, Prishtinë, 2003, f. 297.

<sup>22</sup> Ernest Koliqi, *Bylbylat e Plepshit*, Tregtar flamujsh, 1935, f. 22.

<sup>23</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 103.

<sup>24</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 13.

<sup>25</sup> Po aty, f. 15.

<sup>26</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 24.



“Nânë, më shtro n’odën e vogël,  
se due me fjetë vetëm sonde”<sup>27</sup>.

nëna ia kthen:

“Po flej edhe un me ty, bir-ó, se më duke, pak pa qef e ke nevojë për ndo’i send natën”<sup>28</sup>.

Edhe te novela *Gjaku* kemi tri personazhet e afërta, Nushën me nënën e saj, Drandon, dhe me të fejuarin Dodën. Drando nuk e sheh Dodën si dhëndër, por si fëmijë të saj, duke mos e dalluar me Nushën, fëmijën e saj të vetëm.

Kemi dialogun mes Drandos e Dodës:

“-Shif, bir-ó, nânës s’ate s’ke pse i shtihesh”<sup>29</sup>.

Dadë i drejtohet Mrika nënës së saj, personazhe të novelës *Ke tre lisat te Hija e maleve*:

“-Ulu, dad’ó, ulu e pusho”<sup>30</sup>.

ose

“-Tek â, dad’ó, me enë tjera”<sup>31</sup>.

Në këto dy vepra vërejmë dukshëm elementet farafisnore të shoqërisë shqiptare të përcjellë me shembuj konkretë.

## 2.2 Fjalët përkëdhelëse

Çdo gjuhë e botës duhet t’i ketë fjalët përkëdhelëse, të ngrohta, të buta. Këto njësi gjuhësore zgjedhen nga folësi në raste të veçanta dhe për persona të veçantë. Përmes këtyre fjalëve ne mundohemi ta shprehim dashurinë apo respektin ndaj dikujt. Gjuha shqipe flitet në treva të ndryshme, ka ndarje dialektore dhe sigurisht që pasuria leksikore është jo e njëjtë me njërin a tjetrin dialekt.

Koliqi, si një mjeshtër i shkrimeve në prozë, nuk e kapërcen këtë fond fjalësh, mirëpo e bën pjesë të veprës së tij. Një shembull më i qartë ku i gjejmë të përdorura këto fjalë është novela *Dram i vogël te Tregtar flamujsh*. Tef Ballstani kishte dy fëmijë, vajzën Vildën dhe djalin Viktorin. Djalin, për ta shprehur në mënyrë tjetër dashurinë atërore, e thërret me emrin *Torç*. Djaloshin e vogël kështu e thërret edhe e motra:

“-Torç! Torç! Torç! -erdh tue jehue zâni i së motrës odë n’ odë”<sup>32</sup>.

---

<sup>27</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 21.

<sup>28</sup> Po aty, f. 21.

<sup>29</sup> Po aty, f. 51.

<sup>30</sup> Po aty, f. 126.

<sup>31</sup> Po aty, f. 127.

Te novela *Anmiku në shtëpi* e hasim fjalën *xhanem*, fjalë me prejardhje turke:

“-Pse u apin gjith at randsí vetit, xhanem?”<sup>33</sup>.

Novela *Gjaku*, më e gjata në përmbledhjen *Hija e maleve*, përveç vlerave të tjera që ka, nuk i anashkalon fjalët përkëdhelëse që i bëjnë personazhet të qëndrojnë më afër njëri-tjetrit dhe që pa ngurrim ta shprehin dashurinë, respektin, ndihmën ndaj personave të dashur.

Drandoja, nëna e Nushës, u drejtohet kështu dy të rinjve:

“-Ku jeni more fëmijë të këqij?”<sup>34</sup>.

T’i thuash çdokujt *fëmijë* dhe *i keq*, do të merrte një kuptim më të vrazhdë. Mirëpo, Drando e dinte se përballë saj ishin vërtet dy fëmijë të saj, që i donte, Nushën dhe dhëndrin Dodën.

Edhe fjala *zonjushë* në këtë fjali e ka po të njëjtin kuptim:

“-E ti, zonjushë, qi i ke lânë çarapët pa arnue e ke ndëjë me duer n’ijë gjith mbasditën?”<sup>35</sup>.

Autori shkodran e njihte shumë mirë shpirtin e ndjesitë e shqiptarit. Vepra e tij hedh dritë në çështje kulturore, ngrit vlerat, mbron traditat e zakonet, ndonëse në përballje me realitetin e një botë që po modernizohej çdo ditë e më shumë.

### 2.3 Pritja dhe respekti ndaj mikut

Kânuni apo Kodi i Maleve, i mbetur larg vëmendjes së të huajve, ndryn në vetvete norma juridike të stërlashta, të afta të qeverisin në mënyrë të mahnitshme jetën e një shoqërie heroiko-patriakale<sup>36</sup>.

Mikpritja është ideal i rëndësishëm në shoqërinë shqiptare. Miku përveç që duhet pritur me të ngrënë e të pirë, ai duhet pritur edhe me zemër.

“Koliqi, jo rrallë, në tregimet e veta, sidomos në përmbledhjen e tregimeve “*Hija e maleve*”, shfrytëzon lëndën nga krijimtaria popullore apo kodi kanunor i Lekë Dukagjinit, ku në mënyrë afirmative mishërohen karakteristikat themelore të antropologjisë së botës shqiptare, karakteristikat e botës së arketipave dhe prototipave”<sup>37</sup>.

Në jetën shqiptare çdo gjë rregullohej me kanun. Nuk njihte plaku organet qeveritare, as xhandarët. Ishte ligji i tyre, i pashkruar, por që njihej me zemër e që jetonte e vepronte ditë e natë në Malësi.

---

<sup>32</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 31.

<sup>33</sup> Po aty, f. 21.

<sup>34</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 31.

<sup>35</sup> Po aty, f. 31.

<sup>36</sup> Ernest Koliqi, *Ese të letërsisë shqipe*, Botimet IDK, Kumi, 2005. f. 19.

<sup>37</sup> Arben Hoxha, *Poetika e prozës së Ernest Koliqit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005, f. 182.

Autori shkodran e vë në pah fenomenin e mikpritjes më së miri në novelën *Miku te Hija e maleve*. “E zakoni e detyronte me e pritë e me bisedue me të si me mâ të shtrëjtin dashamirë, mbasi i kishte râ mik te shtëpija”<sup>38</sup>.

Mik quhet edhe armiku më i madh nëse merr rrugën drejt shtëpisë tënde. Kështu e kishin shqiptarët. Koliqi e trajton këtë temë shumë aktuale të shqiptarët duke treguar edhe një herë zotësinë e tij në prozë. Ai në përmbledhjet e tij *Hija e maleve* e *Tregtar flamujsh* ka prekur temat me karakteristike të vendit të tij.

Personazhi i novelës *Miku*, Uc Lleshi, togër në Malësi, vihet në detyrë ta zë e ta dorëzojë në polici gazetarin që përndjekej për shkaqe politike. Si i vjen puna këtij malësori! Natën kthehet në shtëpi kur i tregojnë se i kishin ardhur dy vizitorë; Gjokë Vata, vrasësi i vëllait dhe Shefqet Kadija, gazetari i kërkuar. Edhe pse në këto raste janë miq të mirëseardhur. Me këtë fjalë e përshëndet Uc Lleshi Shefqet Kadinë: “Por ani, s’ka gajle: pa besë e pa miq s’ka ç’a na duhet as jeta në këto malet t’ona”<sup>39</sup>.

Me personazhin e Uc Lleshit autori përfaqëson tërë malësorët shqiptarë, që edhe armikun në shtëpinë tënde duhet ta presësh si mik.

Siç thotë edhe vetë Koliqi në këtë novelë: “*Shqipnija ka zakone të çuditëshme*”,-bën të ditur sakrificën e një populli të tërë përballë jetës së vështirë në Malësi e përballë intrigave të jetës.

Në kanun thuhet: “*Po te hini miku ne shpi, gjak me të pasë, do t’i thuejsh: Mirë se erdhe!*”<sup>40</sup>.

## 2.4 Miqësia (hatri i miqësisë së vjetër)

Një dukuri tjetër shoqërore që e karakterizon botën shqiptare, shpirtin shqiptar. Koliqi këtë gjë më së miri e paraqet në novelën e parë të përmbledhja *Tregtar flamujsh*, të cilin emër e mban edhe tërë përmbledhja.

Kemi dy personazhe kryesore: Gaspër Tragaçi dhe Hilush Vilza, dy personalitete të kundërta me njëri-tjetrin; i pari tregtar shkodran, shok i babait të Hilushit, ndërsa i dyti djalë i shkolluar që kthehet në Shkodër pas disa viteve. Flamujt e mbyllur me vite në dyqanin Gasprri mendonte t’i shiste përmes Hilushit.

---

<sup>38</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 98.

<sup>39</sup> Po aty, f. 101-102.

<sup>40</sup> Shtjefën Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Kuvendi, 2001, f. 66.

Me këtë shprehje fillon provokimi i tregtarit: “-Më kanë thënë se din me qitë vjerrsha”<sup>41</sup>.

Hilush Vilza nuk ishte njeri i paditur për të mos e kuptuar dinakërinë e Tragaçit. Vilza ia jep përgjigjen e merituar tregtarit të pangopur: “-Për hatër t’asaj miksije tash qes bejta me t’u shitë flamujt”<sup>42</sup>.

Novela përfundon me përçarjen e dy personazheve, të cilat ishin krejtësisht të ndryshme: njëri që donte të shiste flamujt kombëtarë përmes bejtave, ata flamuj që nuk i mbante për moral të mrë, siç ua interpretonte të tjerëve dhe tjetri personazh që donte një Shqipëri të ngritur me njerëz të ditur që të sjellin dritë në errësirën shekullore.

Në parathënien e librit *Tregtar flamujsh* Camaj thotë: “Vepra letrare e tij, në kushte normale, s’do të kishte nevojë për paraqitje, ajo flet vetë për vete vetëm tue e lexue”<sup>43</sup>.

Koliqi në novelat e tij ka spikatur pikat më të forta të popullit shqiptar duke i shfaqur edhe një herë vlerat kulturore shqiptare dhe karakteret e këtyre njerëzve që të gjitha virtytet njerëzore i morën në malet e vendit të tyre, ku i rriti dhe i plaku ligji i kanunit.

Miqësia, qoftë e re, qoftë e vjetër, qoftë e tij/saj, qoftë hatri dikujt, është shtyllë e fortë që mban në këmbë tiparet e tjera të një njeriu dinjitoz në vendin tonë.

Koliqi sa u përket zakoneve e traditave shqiptare e shihte të nevojshme ruajtjen e tyre me fanatizëm, por me përjashtim të disa të metave që gjallëronin brendapërbrenda atij grumbullimi vlerash. Për shembull Vilza është njeriu tipik përparimtar, i etur për dije e ngritje vetëdijeje kombëtare e njerëzore, kurse tregtari del në skenë si njeri lakmitar që në fund shpërblehet me asgjë.

## 2.5 Përshëndetjet

Koliqi sjell në shkrimet e tij, në këtë rast në prozë, gjuhën tipike geqe. Janë me interes t’i shohim e t’i studiojmë shprehjet që janë përdorur si përshëndetjet në novelat të *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*.

Secila krahinë a zonë shquhet për përdorime të veçanta të shprehjeve gjuhësore, si për përshëndetjet, fjalët e urta, shprehjet në rastet e gëzimit a të pikëllimit, kur lind a vdes dikush etj. Të gjitha këto elemente e pasurojnë fushën gjuhësore që merret me kulturën gjuhësore të një vendi.

---

<sup>41</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 6.

<sup>42</sup> Po aty, f. 11.

<sup>43</sup> Po aty, f. 6.

Ekzistimi i shumë varianteve gjuhësore të gjuhës shqipe bën që të ketë lloj-lloj shprehjesh për një dukuri të caktuar, për shembull nëse krahasojmë shprehjet e shqiptarëve të veriut me të atyre të jugut në një rast fejese, do të gjejmë dallime në përdorime gjuhësore, do të ketë diçka të re në njërin a tjetrin dialekt. Ose në raste mortore me rastin e vajttimeve a gjëmave do të ketë një diversitet të madh në mes zonash të ndryshme të Shqipërisë a të Kosovës. Ashtu edhe në përshëndetje do të dalin variacione, për shembull kur takohemi a ndahemi me dikë.

Në novelat e Koliqit të *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh* hasim një numër të mjaftueshëm shprehjesh në rastin e përshëndetjeve që do të ishin me interes t'i interpretonim, sidomos ato shprehje që dëgjohej në oda të miqve.

Te novela *Gjaku* kemi shprehje të tilla kur i shkon miku t'i çojë fjalë për vdekjen e të vëllait, Zekës: “-*Mbramja e mirë, -përshëndeti tue hÿ, kur u çël dera.*

*-Mirë se vjen, -përgjegji grueja*<sup>44</sup>.

Kemi pastaj shprehjen: “-Ç'â zâni, lum miku?”<sup>45</sup>.

Te novela *Miku* i gjejmë këto shprehje të tilla: “-*Hade, byrum.*”,<sup>46</sup> “*Udhambarë*”,<sup>47</sup> “*Mbrâmja e mirrë, burra, e mirë se u ka prû Zoti.*”,<sup>48</sup> “*T'ârdhëshim për të mirë, Uc Lleshi.*”,<sup>49</sup> “-*Kjofsh me jetë e e mira të gjetët*”,<sup>50</sup> “-*Paç të mbarë e Zoti të ruejtë, Uc Lleshi*”<sup>51</sup>.

Edhe novela *Kur orët lajmojnë* e gjejmë shprehjen: “-*Hajde, byrum: mirë se u ka prû Zoti*”<sup>52</sup>.

*Vëna shtatë vjeçe* ka këto përshëndetje: “-*Mirë se u ka prû Zoti, djelmoça!*”<sup>53</sup>.

Një ditë prej ditsh një novelë tjetër të *Tregtar flamujsh* që trajton temën sociale të shtresave të qytetarëve. Një bojaxhi bëhet merak në vajzën e pronarit të shtëpisë që po ia lyente çardakun. Atij veç një fjalë ia mori dhe ia theu zemrën: “-*Puna e mbarë*”<sup>54</sup>.

---

<sup>44</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 34.

<sup>45</sup> Po aty, f. 34.

<sup>46</sup> Po aty, f. 94.

<sup>47</sup> Po aty, f. 95.

<sup>48</sup> Po aty, f. 98.

<sup>49</sup> Po aty, f. 101.

<sup>50</sup> Po aty, f. 101.

<sup>51</sup> Po aty, f. 102.

<sup>52</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 114.

<sup>53</sup> Po aty, f. 36.

Te novela më e gjatë e Tregtar flamujsh kemi këto shprehje: “*T’u ngjitët jeta zotni-përshëndeti Malsori. T’u ngjatët me nderë*”<sup>55</sup>, “-Hajt, Bajram, ta priftë Zoti mbarë!”<sup>56</sup>, “-Tungjatjeta, Henrik”<sup>57</sup>.

Shprehjet gjuhësore pothuajse janë të njëjtat përshëndetje si në njërën a të tjetrën shtëpi. Rëndësia e tyre qëndron në origjinalitetin e tyre duke sjellë në krijimtarinë e Koliqit frymën e vërtetë të vendit.

## 2.6 Fejesa (shkuesia)

Është një ndër ceremonitë e shumta që te shqiptarët përcjellat me zakone, që e shquajnë kulturën shqiptare dhe që e dallojnë nga kulturat e vendeve të tjera. Karakterizohet me rite të shumta.

Fejesa dallonte prej rastit në rast. Disa bëheshin më herët, disa më vonë, disa me dëshirë, disa me obligim. Vajzat shqiptare nuk guxonin të flisnin për fejesën e tyre, për burrin që do ta merrnin dhe për asgjë tjetër. Familja ishte vendimtare në këso rastesh, e cila sipas zakoneve pyeste për shtëpinë që ia kërkonin vajzën, për pasurinë që kishin, për nderin e emrin.

Për ndryshim nga kohërat moderne, dikur vajzat fejojeshin në moshë shumë të re, disa nuk mbaronin ende shkollën e disa prej kur ishin në djep fejojeshin. Mjaftonte që dy miq të vjetër ta bënin llaf punën e fëmijëve të tyre dhe aty lidhej miqësia mes dy familjeve.

Fejesat në përgjithësi bëheshin me *shkuesi*, d.m.th dërgohej një njeri i besueshëm nga familja e djalit për ta kërkuar vajzën e *filanit*. Shkuesi paguhej për punën që kishte për ta kryer. Kanuni thotë: “*Nuse pa shkuesi s’bahet*”<sup>58</sup>.

Ndër zakonet më të rënda ishte çështja e fejesave dhe e martesave. Koliqi duke e njohur mirë këtë anë të popullit të tij, e trajton me kujdes e hollësi, duke i bërë sa më origjinale tregimet e tij. Secili shqiptar i njeh mirë këto dukuri që Koliqi i hodhi me mjeshtëri në letërsinë shqiptare.

Në novelat e Koliqit preken disa nga elementet shqiptare në cermonitë e fejesave.

Te *Kânga e re* në përmbledhjen *Hija e maleve* kemi rastin e Ton Laskut, këngëtarit të njohur shkodran dhe të vajzës nga dera e kamur. Koliqi në këtë novelë tregon tregon pabarazinë e shtresave shoqërore si

---

<sup>54</sup> Po aty, f. 102.

<sup>55</sup> Ernest Koliqi, Tregtar flamujsh, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 117.

<sup>56</sup> Po aty, f. 128.

<sup>57</sup> Poaty, f. 140.

<sup>58</sup> Shtjefën Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Kuvendi, 2001, f. 13.

pengesë për t'u fejuar dy të rinj. Nuk pranonte kurrë një njeri i derës së madhe ta bënte mik një njeri të thjeshtë. Personazhi Ton Lasku e shpreh dhembjen përbrenda për padrejtësinë e jetës.

Koliqi e interpreton me këto fjalë:

*"Në një rasë tjetër do t'i kishte rënë për shkurt: do ta kishte lypë dhe do ta kishte marrë për grue. Por ajo qilloi derën së parë dhe ai e dinte mirfillit që atij, po t'a kërkonte, kurrsesi nuk do t'ia jepshin"*<sup>59</sup>.

Zhgënjimi duket edhe në shprehjen:

*"Si kishte mujt ai me shpresue se një vajzë dere bujare do ta pranonte?"*<sup>60</sup>.

Çështja e fejesave në Shqipëri, por edhe në Kosovë, ishte shumë delikate dhe traditat kërkonin zbatim.

Koliqi shprehet:

*"Nderi i vajzës është si gjami që fryma më e lehtë i a pakson qartësinë..."*<sup>61</sup>.

Janë me interes për gjuhën shprehjet e tilla kur thuhet fjalë të mira ndaj vajzës:

*"Është shumë vajzë e shyreçme...është shtëpijet të mirë, e urtë, bojagi e hjesme, e rritur me kujdes, me shkollë..."*<sup>62</sup>.

Gjaku ishte barrikada në mes dashurive të malësorëve. Novela *Ke tre lisat* bart mesazhin e kësaj teme, ku dy personazhet, Mrika e Gaci, i japin fund dashurisë së tyre:

*"Pse un s'kam me të thirrë më kurr. Kena gjakun ndërmjet..."*<sup>63</sup>.

Dashuria del e dobët kundrejt ligjeve të atyre maleve.

*Bylbylat e plepshit*, një nga novelat e *Tregtar Flamujsh* prek temën e fejesës. Loro Shegori dhe Hilush Vilza shokë të pandashëm dhe njerëz të ngritur të asaj kohe në Shkodër nuk e paramendonin fejesën e tyre me shkuesi.

---

<sup>59</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 65.

<sup>60</sup> Po aty, f. 66.

<sup>61</sup> Po aty, f. 66.

<sup>62</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 52.

<sup>63</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 138.

Koliqi në veprat e tij jep mesazhin që të ruhen vlerat kombëtare shqiptare duke i larguar veset që ishin të pranishme si gjakmarrja. *“Ky autor është i bindur që rrënjët e kombit janë në gjuhën dhe në kulturën e tij, prandaj në secilën kohë e fazë të zhvillimit të saj kjo kulturë, që nga antikiteti deri në modernitet, duhet të zhvillohet duke ruajtur antikitetin e vet”*<sup>64</sup>.

Pra, në rastin e fejesave a në manifestime të tjera kulturore kishte anë të mira dhe të këqija. Individët e shoqërisë shqiptare, në shumicën e rasteve femrat, pësonin të metat e asaj shoqërie të prapambetur dhe të ngjuar në një kohë të caktuar, e që s’përparonte drejt rrugës së civilizimit.

*Lumnia*, novelë tjetër të *Tregtar flamujsh*, përfaqëson botën e femrave shqiptare, të cilat u përgjigjen pyetjes se ç’është lumturia.

Shqiptarët bënin jetë të thjeshtë brenda maleve të vendit dhe lumturinë ia sjellnin pikërisht gjërat e thjeshta.

Personazhi i shërbëtores, Dalina, flet për çdo femër të asaj kohe në Shqipëri duke u bërë zëri dhe ndjenja e secilës. Fati i saj kishte qenë të fejohej sa ishte në djep dhe nderi dhe lumturia e saj ishte burri i saj që nuk e kishte parë:

*“-Tata me ka fejuë në djep. Burrin tëm s’e njof as dij gjâ për të, pse âsht turp me vetë vajza për djalë, por tash një ditë biseduen në shtëpi edhe thânë se ka marrë një gjak të vjetër edhe e levduen për pushkë të bukur qi kish qitë. Um kallxoi të drejtën, u shendova s’a s’ka”*<sup>65</sup>.

Veprat e Koliqit kanë tema origjinale të botës shqiptare para modernitetit të ditëve të sotme.

## 2. 7 Vdekja

Populli ynë njihet për tradita në ceremoni të ndryshme kulturore. Popujt e ndryshëm kanë kultura të veçanta dhe kështu në botë bëhet numër i madh traditash në mjediset shoqërore. Nëse e shikojmë edhe një popull të vetëm shohim, na shfaqen variacione kulturash midis krahinave të ndryshme. Vdekja-pjesë e pandashme e një mjedisi të gjallë. Kultura shqiptare edhe këtë pjesë të saj ka një grumbull rregullash, ligjesh që duhet t’i zbatojnë njerezit. Koliqi ka arritur t’i pasqyrojë çështjet më të ndërlikuara të shoqërisë shqiptare. Novelat e tij sjellin tregime po të gjalla ta përjetosh ngjarjen e t’i shohësh, e t’i njohësh personazhet nga afër. Vendi ku zhvillohen ngjarjet ndihmojnë më të gjallë rrëfimin e të shtrihet në një petk në mënyrë të përsosur.

<sup>64</sup> Sabri Hamiti, *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003, f. 439.

<sup>65</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 108.



*Hija e maleve* ka novelën *Gjaku* që mbërthen temën e rasteve mortore, *Se qofsh*

*Pleqnofsh, Kur orët lajmërojnë, Ke tre lisat, Diloça dhe Zana e fundme.*

Te *Gjaku* kemi të bëjmë me vdekjen dhe gjakmarrjen kur Zeka i Dodës, vritet nga Nikë

Feta.

Zakonet e vdekjes në Shqipëri nuk pyesin për dhembje a mërzi, por ato kërkojnë të kryhen

punët në këto ditë të zeza që mos turpërohen para botës. Ditët e zisë ishin të zymta, të heshtura, të rënda.

Të gjithë ata që shkonin për kryeshëndoshë, vesheshin në petka të zeza, simbol i pikëllimit në të tilla humbje. Njerëzit mbushnin shtëpinë, hynin e dilnin. Të shtëpisë kishin për detyrë t'i kryenin të gjitha zakonet që kërkoheshin në raste mortore.

Doda, një njeri i shkolluar, i ecur përpara, ishte njeriu që kishte mbetur në një gjendje

të padëshirueshme. Traditat ati ia zinin frymën, e tërheqnin prapë andej nga kishte ardhur, në ato vende të lëna anash nga koha, nga njerëzit, nga jeta.

Koliqi në këtë novelë shprehet:

*“Detyrat e shuma qi një zot shtëpie do te plotësoj në Shqipni ndër rasat e tilla, s’e lënë t’a mendoje thellë aty për aty mjerimin qi e gjeti.”<sup>66</sup>.*

Koliqi i zbulon këto anë të vendit tonë për t'i ndërtuar, për t'i ruajtur e jo për t'i

Eliminuar nga trangu shoqëror.

Personazhi i Dodës në këtë novelë bart individin që lufton në një shoqëri të tërë, i cili duke

qenë vetëm mposhtet nga ajo dhe bie nën ndikimin e saj. Mësuesi i mbetur në mes dy

zjarreve: në njërën anë familja dhe në anën tjetër ana e tij intelektuale e ndërtuar me shumë

---

<sup>66</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 35.

mund, kthehet prapë nga e kaluara bëhet pre e mentalitetit vendor dhe merr gjakun e vëllaut.

*“Në këtë shpalim etno-psikologjik, Ernest Koliqi si mjeshtër i madh i letërsisë etnike e të zakoneve shqiptare, mbetet i paanshëm: ai vetëm përpiqet të shfletojë kindet e jetës, për të janë domosdotë e trajtave të saj”<sup>67</sup>.*

Erë vdekjeje kemi në novelën *Se qofsh, pleqnofsh*, ku babai Sufa vret bijën Minën që e kishte çnderuar shtëpinë.

*Deka, kapak ari*<sup>68</sup> ishte për shqiptarin e rrënuar moralisht.

Çështja ndërlikohet më tej në këtë novelë kur Sufës i kërkojnë gjak familja e Hajdar Litit, njeriu që ia kishte lënë shtatëzënë vajzën. Kësi lloj problemesh rregulloheshin me pleqësi dhe Koliqi e shpall fitoren e babait Sufës me një dialog të shkurtër:

*“-Pse m’â derdhe at miell?”*

*-Ça kërkoi mielli i yt në thes t’em?*

*-Se qofsh, pleqnofsh?”*

Te novela *Kur orët lajmrojnë* kemi veprimin e figurave mitologjike të Orave të malit, të cilat e lajmërojnë vdekjen e njërit nga dy personazhet, dy shokëve, Gjeto Marku dhe Lulash Prela:

*“-Orët!” “E...a e din çka donë me thënë?...”*

*“E dij: mbrënda këtyne shtatë ditëve njëni prej nesh des”<sup>69</sup>.*

Koliqi ndërlidh me shkathtësi elementin *vdekje* me mitologjinë shqiptare.

*Ke tre lisat* novelë që sjell vdekjen dhe ndarjen e dy të rinjve për shkak të armiqësisë

---

<sup>67</sup> Sabri Hamiti, vep.cit. f. 458.

<sup>68</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtine, 2003, f. 79.

<sup>69</sup> Po aty, f. 113.

Së familjeve të tyre.

Novela *Diloca* bart elementin e vdekjes dhe të tragjedisë së vajzës jetime të mbetur vetëm në një jetë plot lëkundje e rreziqe që ndjekin edhe në vdekje.

Diloca para martesës arratiset me të dashurin e saj, për ta shmangur një martesë pa dashuri, mirëpo mbetet vetëm ngase Mark Lulashin, djalin që donte, e vrasin:

*“Marku m’u ftoj në prëhën, pa kënë un e zoja me ba kurrqja për të.*

Fati i të rinjve përcaktohej nga dikush tjetër duke i lëvizur si marioneta:

*“Por shpesh ndër malet t’ona, dashunija dhe deka janë sinonime”<sup>70</sup>.*

Vdekja na del si element edhe në novelën e fundit të *Hija e maleve, Zana e fundme, ku kemi vdekjen e figurave mistike, zanave, thënë simbolikisht për vdekje të virtyteve të popullit shqiptar:*

*“Kur kânga e vajit, qi janë ushqimi i tyne, erdh tue u mungue, Zânat zûnë m’u mërzitë: Mërzija i mbyti një nga një”<sup>71</sup>.*

Elementi i vdekjes të Tregtar flamujsh haset të novela *A ta laçë, Vaji i qitun dhe Hânë gjaku*.

Te novela *A ta laçë* na shfaqet kulti i vdekjes. Novela fillon me gëzimin, qetësinë e njerëzve gjersa po shijonin kohën e bukës, kur andej kalon një grumbull njerëzish që po e përcjellnin një të vdekur. Kemi ftohtësinë e vdekjes që sjell te secili njeri e te secila gjallesë:

*“Ai trup i panjoftun, dikur plot rini e tashti amollues n’arkivol, me gjak të ngrîm ndër fyza, me mishuj të zhgrehun në mish qi njomsija e mystershme e jetës s’këndellte mâ, kaloi para dy trupave të rij ndër të cilët gjaku këndonte kângën e vet të shkurtë e të shpejtë e plot nxehtësi gjallnore”<sup>72</sup>.*

*“Te tregimi A t’a laçë..., si filizofi, kemi përplasjen e gëzimit me hidhërimin e vdekjes,*

*Binomi jetë-vdekje...”<sup>73</sup>.*

---

<sup>70</sup> Po aty, f. 158.

<sup>71</sup> Po aty, f. 162.

<sup>72</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 19.

Në bazë të titullit identifikohet shenja e mortit te novela *Vaji i qitun*. Kishte vdekur vëllai i

Çintos, Kola, gjersa ishte në Milan. Koliqi vargëzon shprehje gjuhësore të familjarëve të vrarë

shpirtërisht: “-Kukú, bir! U nise prej shtëpis sate shndosh e mirë si topi, bir! Po pse m’i nylene

kështu me karabojë nânën e motrat, bir?!”, “Kjofsh vetë!”<sup>74</sup>. Traditat e shqiptarëve ishin të

rënda. Koliqi ka personazhin e Çintos, vëllai i të vdekurit, te i cili e bart tërë ngarkesën e tyre.

Çinto nuk ka as kohë për t’u mërzitur për të vëllanë, se kërkoheshin mijëra detyra e punë për të

pritur njerëzit. Atij i kërkoheshin rrobat e zeza, të mos pastronte fytyrën e të gjitha këto e zemëronin

Çinton me secilin që i përfillte ende këto zakone, që të merrnin kohë e s’të jepnin asgjë në këmbim.

Hasim këto shprehje brenda kësaj novele: “E shkreta, ndiqte zakonet ashtu lypej në Shkodër”<sup>75</sup>.

“Grát i gjet të rrjeshtueme n’odë të t’et, të gjitha mbule ktyet meruba të zeza.”,<sup>76</sup>...kunora e gráve rreth s’ámës s’dekunit n’odë tjetër”<sup>77</sup>.

Në këtë novelë zakoni triumfon mbi gjithçka. Zemërimi e mbante Çinto e prapë se prapë ishte i detyruar t’i përshtatej vendit.

Edhe *Hânë gjaku* përmban elementin e vdekjes. Personazhit të kësaj novele, një të riu, hëna e kuqe i shënonte një kob. Ishte mbrëmje dhe ai po shëtiste me të dashurën buzë Drinit. Në shoqëri iu bashkangjiti hëna me dengë të kuqe, që i solli trishtim.

Pikërisht një hënë si kjo kishte paralajmëruar vdekjet në luftërat e shqiptarëve me të huajt. Në atë kohë po udhëtonin nga Podgorica në Nikshiq, ku rrugës u kishte dalë një plakë malazeze duke bërtitur dhe treguar afrimin e një kobi: “-Kukú për Malin e Zi! Kukú për gjithë botën qi ka m’u mbytë në gjak! Pushkët e Malsorve të Hotit, kanë me ndezë një zjarm qi, kukú, vonë e vonë do të shuhet”<sup>78</sup>.

---

<sup>73</sup> Nysret Krasniqi, *Autori në letërsi*, AIKD, Prishtinë, 2009, f. 127.

<sup>74</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 46.

<sup>75</sup> Po aty, f. 47.

<sup>76</sup> Po aty, f. 48.

<sup>77</sup> Po aty, f. 49.

<sup>78</sup> Po aty, f. 114.

Koliqi trajton temën e vdekjes në forma të ndryshme. Pak prej vdekjeve na dalin të natyrshme, se shumica ishin pasojë e gjakmarrjeve, një ves i shqiptarëve, i pashkëputur prej shoqërisë dhe që sjellte veç të këqija.

Jo kot Koliqi i ka trajtuar temat e tilla të shoqërisë shqiptare. Ai i bëri pjesë të veprave të tij për të treguar se, ndonëse disa të dëmshme, nuk çrrënjëzohet as kultura e as gjuha e një populli.

## 2.8 Elementet fetare

Njeriu jeton, vepron sipas vendit ku është. Secili individ ka një kulturë të përgjithshme, si në të folur, në të ngrënë e në të pirë, në të përshëndetur, në të jetuar etj. Kjo bën që ai të jetë unik ndaj çdokujt.

Edhe një popull duke pasur një formim të hershëm, fiton një kulturë të vetën.

Koliqi në novelat e tij arrin t'i përmbledh kulturat e shqiptarëve, karakteristikat e tyre si shoqëri, si traditat që kanë në mikpritje, në raste të gëzimit, të pikëllimit etj. Ndër to me interes për temën tonë është t'i shohim elementet fetare që i ka përdorur Koliqi në novelat e tij të *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*.

Te shumica e rasteve hasen elementet e besimit katolik si: *Kisha e Madhe, mesha, të rrëfyerit, kryqi, kisha, prifti, famulltari* etj.

Novela e parë të *Hija e maleve* fillon me këtë paragraf ku shihen elementet fetare: "*Kumbonza e kumbonares së vogël dha lajmin e mbarimit të meshës. Bashkë me tingllat e qarta të saj, u shpërndanë nëpër ledinë të gjelbër gjint qi delshin prej kishet.*"<sup>79</sup>

Koliqi në këtë pjesë na njofton që kemi të bëjmë me një mjedis të besimit katolik.

Kemi pastaj fjalinë: "*Granija delte prej ishe tue bâ kryq pa pushue e tue puthë medajat e rruzareve.*"

Te novela *Gjaku* ndeshim shprehje të tilla: "...pasha Zotin.",<sup>80</sup> "*Pashë fën qi kena...*",<sup>81</sup> "...prite Zot",<sup>82</sup> "...rahat me Zotin!"<sup>83</sup>

<sup>79</sup> Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 15.

<sup>80</sup> Po aty, f. 26.

<sup>81</sup> Po aty, f. 49.

<sup>82</sup> Po aty, f. 50.

<sup>83</sup> Po aty, f. 52.

*Kânga e re* përmban shprehjet me elementet fetare si: “-I ka bâ Zoti nafakë, moj loce.”,<sup>84</sup> “Por u ngjalle si Sh'Lazëri...”<sup>85</sup>

Te novela *Se qofsh, pleqnofsh* hasim këto elemente: “Prite, Zot!”,<sup>86</sup> “...pa pasë kurrkush të drejtë, posë Perëndís, me futë turinin në punë të mija.”<sup>87</sup>

*Kur orët lajmojnë* përmban këto shprehje me natyrë fetare: “E..., 'asha Zotin, veç prej ngushticet se s'i kishna vrá ata dy!”,<sup>88</sup> “...çou të shkojmë e të rrefehena.”,<sup>89</sup> “-Lâmetênzonë!-Me Tênzonë vofsh e kjoqsh.”.<sup>90</sup>

Shprehjet: “Atëherë merre figurën e Zojës qi ka prû Zeka...”<sup>91</sup> “-Jezus-Marija!”<sup>92</sup> “-Lâmetêntnë!”<sup>93</sup>, i kemi te novela *Ke tre lisat*.

Te *Diloca e gjejmë të tillë urimin me elemete fetare*: “-Eh, lum zotnija, ty të rritë Zoti jetën...”<sup>94</sup>

Te përmbledhja *Tregtar flamujsh*, për dallim nga Hija e maleve, hasen edhe elemente të besimit islam te novela e fundit *Djepi arit*. Këtë na e dëshmojnë shembujt: “Në majën e shkopit të gjatë qi kishte në dorë Lorja vûri roe nji lëmue e u kujtue se mbante Ramazanin.”,<sup>95</sup> “Ndore Zotit e tanden”,<sup>96</sup> “Qe, besa e Zotit.”,<sup>97</sup> “...minarja e Xhamís së Fushës së Çelës...”<sup>98</sup> Në këtë novelë edhe vetë emri i personazhit kryesor është mysliman: *Bajram*.

Te novelat e tjera kemi shprehje e shembuj prej fesë katolike. Te *Anmiku në shtëpi* kemi mallikimin e përsëritur disa herë brenda novelës “*Faroj, o Zot!*”.

Te *Vaji i qitun* kemi të përmendur emrin e Kishës së Madhe.

---

<sup>84</sup> Po aty, f. 68.

<sup>85</sup> Po aty, f. 71.

<sup>86</sup> Po aty, f. 74.

<sup>87</sup> Po aty, f. 82.

<sup>88</sup> Po aty, f. 111.

<sup>89</sup> Po aty, f. 113.

<sup>90</sup> Po aty, f. 115.

<sup>91</sup> Po aty, f. 128.

<sup>92</sup> Po aty, f. 133.

<sup>93</sup> Po aty, f. 139.

<sup>94</sup> Po aty, f. 150.

<sup>95</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 118.

<sup>96</sup> Po aty, f. 120.

<sup>97</sup> Po aty, f. 121.

<sup>98</sup> Po aty, f. 125.

Vepra e Koliqit nxjerr vlera të mëdha gjuhësore prej kulturës së popullit shqiptar. Ai ka vjelë materialet nga më autoktonet. Shkrimet e tij janë pasqyrë reale e Shqipërisë së shekullit të kaluar.

## 2.9 Urimet për ditën e emrit

*“Familja asht një t’mbledhun gjymtyrësh, të cillët gjallisnin nën një kulm, qëllimi i të cillvet asht të shtuemt e gjindes nper mjet të martesës, të mkamunt e tyre kah zhdivillimi i shtatit e kah zhvillimi i mendes e i shises”<sup>99</sup>.*

Kanuni e shihte familjen si bashkësi njerëzish që do t'i shërbente shtëpisë për punë e

për çdo nevojë tjetër. Lindja e fëmijës, sidomos e një djali, do të thoshte të rritej familja, të shtohet një krah pune në shtëpi.

Foshnja sapo të lindte, pagëzohej me një emër. Çdo vit festohej dita e emrit kur njerëzit urojnë personin e caktuar.

Ne do ta prekim këtë çështje në novelat e Koliqit, sepse nxjerrim shprehje gjuhësore që përdorin në raste të tilla dhe do të jenë me interes për kulturën gjuhësore.

Në novelën *Nji ngjarje në rrugacën “Kezenaj”* me këtë fjali shënohet fillimi i festës së ditës së emrit: *“Zefë Sinadinin qyshë n’orën tetë filluen me i ardhë miq për vizitë për ditën e emnit.”*<sup>100</sup> Mysafirët pritëshin me kafë, cigare e raki. Urimet thuheshin sa herë që ngritej gota për të pirë.

Autori rendin e asaj ndejeje e paraqet kështu: *“Miqtë hyjshin e, tue përçapë ngutëshëm*

*përshëndetje e urime, ia shtrëngojsin dorën mâ parë atij e mbandej rrjeshtit të grave, - në*

*kâmbë në një anë t’odës, mâ e motnuemja në krye e mâ e reja në fund - edhe uleshin me ndëjë. Zefi u epte cingare, ua ndizte edhe zënte vënd në ndëjse kundruell tyne.”*<sup>101</sup>

Pra, ata që gjendeshin aty, kishin rend, uleshin sipas moshës a vendit që e kishin në atë shtëpi.

Urime për këtë ditë në këtë novelë kemi: *“E gzoftsh për shum mot.”*<sup>102</sup> *“...ma gëzoftsh për shum mot. Sot nji vjet me nji nuse.”*<sup>103</sup>

Koliqi spikat në këtë novelë edhe natyrat e ndryshme të njerëzve kur thotë: *“Këtij s’i tha as “e gzoftsh” as “për shumë mot”simbas zakonit, por “urime”.*<sup>104</sup> Këtu shihet roli i gjuhës në përcaktimin a interpretimin e intelektualitetit të një individi.

<sup>99</sup> Shtjefën Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Kuvendi, 2001, f. 7.

<sup>100</sup> Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 88.

<sup>101</sup> Po aty, f. 88.

<sup>102</sup> Po aty, f. 90.

<sup>103</sup> Po aty, f. 94.

Gjuha përcakton kulturën e përgjithshme të çdo folësi. Ndryshe do të uronte një i moshuar, që duhet të jetë i pashkolluar, e ndryshe do të uronte një i ri, intelektual, i shkolluar.

Novelat e Koliqit bartin vlera gjuhësore e kulturore, që janë identiteti i një populli. Prania e këtyre vlerave e bën veprën e tij të arrirë në nivelin përmbajtësor të ndërthurur në mënyrë të përsosur me artistiken.

---

<sup>104</sup> Po aty, f. 96.



## PËRFUNDIME:

Ernest Koliqi bën pjesë në radhën e personaliteteve më të rëndësishme të kulturës dhe historisë shqiptare. Përmes veprave që kemi marrë në analizë si *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*, mund të themi se Ernest Koliqi është një njohës i mirë i psikikës njerëzore, një njohës më se i mirë i traditave dhe zakoneve shqiptare. Ernest Koliqi me gjithë trashëgiminë e tij krijuese, zë një vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë dhe të kulturës shqiptare.

Ernest Koliqi, intelektual i shquar, poet, prozator, përkthyes, studiues, profesor universiteti, zë një vend të rëndësishëm edhe në historinë e arsimit shqiptar. Kontributi i tij në arsim merr peshë historike, sidomos për “vitet shqiptare të lirueme”, ku për herë të parë u organizuar arsimit shqip në permasa aq të mëdha dhe në kuadër të një sistemi unik të arsimit kombëtar.

Në studimet e tij shkrimtari Ernest Koliqi e vështron letërsinë në rrjedhat e saj të zhvillimit historik si një nga manifestimet më të fuqishme të shpirtit shqiptar, duke ruajtur atë koherencë të brendshme, që shquhen punimet e tij nga fillimi deri në fund.

Dëshmitë pasionante të punës së Ernest Koliqit në fushën e arsimit shqiptar jepen përmes përmbajtjes dhe kontributeve konkrete që ai sjell me veprat e tij. Në kulturën dhe inteligjencën profesionale që e karakterizon Koliqin vihet robërisht në shërbim të punës për të ingranuar sipas mundësive kulturën tonë me nivelet e kohës nëpërmjet krijimeve origjinale, përkthimeve, botimeve, reformave arsimore. Vizioni i tij për kulturën shqiptare, për gjuhën e letërsisë tonë, e në veçanti për të ardhmen e arsimit, është themelisht i qartë e me prespektivë. I lindur në një ambient katolik shkodran, në kontakt që herët me kulturën perëndimore, Ernest Koliqi nuk e intereson vetëm letërsia e huaj e sidomos ajo italiane me të cilën u formua. Atë e tërheqin gjithmonë vlerat e vërteta të artit tonë tradicional. Kjo i jep personalitetit të tij një peshë të veçantë dhe kuptimplotë si në studime letrare apo në studime gjuhësore.

Studimet në fushën e gjuhësisë dhe sidomos në atë psikolinguistike në ditët e sotme po vijnë e po bëhen objekt studimi. Në këtë punim diplome kemi marrë si rast studimi personalitetin e letrave shqipe, shkrimtarin e mirënjohur Ernest Koliqin. Krijimtaria e tij është e shumëllojshme, por ka qenë e ndaluar politikisht dhe ideologjikisht për rreth 50 vjet, prandaj asaj për një kohë të gjatë i ka munguar lexuesi e receptuesi shqiptar i lejuar në Republikën e Shqipërisë. Kurse në Kosovë nuk ishte e njëjta gjendje, atje vepra e tij lejohej të lexohej e të studiohej.

Ernest Koliqi është krijues i shumë planeve, i krahasueshëm me disa të paktë personalitete në kulturën shqiptare, Ernest Koliqi ka një krijimtari të pasur. Një gjysmë shekulli zgjati krijimtaria e tij letrare dhe po

kaq zgjati edhe kontributi i tij në fushën e mendimit letrar, kohë relativisht jo e shkurtër në jetën e një individi. Ai erdhi në letërsinë dhe kulturën tonë shqiptare në fillim të viteve '20, për të mos u shkëputur për asnjë çast prej tyre deri në fund të jetës së tij dhe, nisur vetëm nga kjo, mund të merret lehtë me mend se kontributet e tij nuk janë të zakonta. Ai erdhi në letërsinë shqipe një koncept të ri e të plotësuar, refleksi i një vetëdije të qartë, me një përkushtim të tillë që shpërfaqej fuqishëm në disa fusha krijimi, si në atë të krijimeve të mirëfillta letrare, të përkthimeve dhe në mendimin letrar shqiptar.

Gjuha e veprës së Ernest Koliqit është e veçantë. Kjo duket në tregimet e shkurtra, në tregimet e gjata, në dramën e shkruara prej tij, në poezitë apo në përkthimet me një cilësi të jashtëzakonshme. S'ka rrafsh gjuhësor në këto vepra, ku ai të mos e tregojë talentin, zotësinë dhe mjeshtërinë, që dallon nga shumë krijues të tjerë dhe që i krijojnë origjinalitetin e veprës dhe të krijimtarisë së Ernest Koliqit.

Me vlerat e veta letrare shumëzhanrore dhe me tërë trashëgiminë e tij si krijues, Ernest Koliqi zë një vend të merituar në historinë e kulturës sonë kombëtare. Krahas ndihmesës së tij në fushën e publicistikës e të arsimit, profili i tij krijues na shfaqet në disa rrafsh si: poet, prozator, përkthyes, kritik e studiues i letërsisë dhe në shumë prej tyre ai la gjurmë të pashlyeshme me forcën e talentit të tij të rrallë.

Në lidhje me këtë temë dhe punim jemi ndalur gjerësisht në kapitullin e dytë, në të cilin kemi marrë në shqyrtim dukuritë me vlera etnolinguistike në dy veprat më kryesore të Ernest Koliqit. Elementet që kemi trajtuar janë: raportet e farefnisës, fjalët përkëdhelëse, pritja dhe respekti ndaj mikut, miqësia (hatri i miqësisë së vjetër), përshendetjet, fejesat që bëhen përmes shkuesisë, vdekjen, elementet fetare dhe urimet për ditën e emrit.

Farefnisi është grupi i njerëzve që kanë lidhje gjaku. Këtu i kemi përfshirë pra njerëzit e familjes e më gjerë. Kjo tërësi njerëzish ruan të njëjtat gjëra si kulturën e zakonet. Familja është bashkësia e disa anëtarëve, që dikur përbëhej nga një numër i madh anëtarësh. Sot ndryshon puna, sepse është zvogëluar numri i njerëzve, që jetojnë në bashkësi.

Burimet e pasurisë leksikore të veprës së Ernest Koliqit janë:

**Burimi i parë** është gjuha e vendlindjes, e folmja e Shkodrës dhe kur ishte në Itali, të folmet arbëreshe. Ernest Koliqi më 1931 shkruan: Gjuha e jonë burimin e vet të pashtershëm e ka në popull. Fjalë, thanje janë mbledh mjaft, gjithnjë mblidhen, prap të tjera do të gjinden qi do të hyjnë në përdorim ma vonë. Por nuk flas për këtë studim makinal, i cili asht i detyrueshëm për çdo Shqiptar. Randësi shumë ma të madhe ka studimi i atij ritmi të çuditshëm qi merr gjuha e jonë në gojë të popullit, kuptimi i saj muzike qi

jehon në fjalët e njerëzve të paprishur nga letërsitë e hueja. Kur flasin njerëzit pa shkrim e pa këndim, një melodi e pazaptueshme rrëshqet në rreshtimin e fjalëve të tyre; thanja u del e njomë, fjali ka lakime mrekullisht të bukura e të zhdërvjellëta, lidhjet janë mjeshtërore e të natyrshme. At melodi, ato karakteristika duhet të përpiqemi me shti në stil t'onë për në daçim me shpesh ma s'miri ndiesit e thella qi msheh shpirti i kombit.

Të komunikosh nuk do të thotë vetëm të marrësh e të japësh informacione, por të hysh në marrëdhënie me të tjerët, të krijosh një imazh për ta dhe për veten. Rreth këtij koncepti janë bërë mjaft përkufizime e interpretime të ndryshme, nisur nga disiplina, si: *pragmatica*, *sociolinguistica*, *etnografia* e të folurit etj<sup>105</sup>.

**Burimi i dytë** është folklori, gjuha e krijimeve popullore si gojëdhënat, këngët, përrallat, eposi i kreshnikëve etj, rreth të cilave bëri studime dhe mbrojti tezën e doktoraturës.

**Burimi i tretë** është gjuha e trashëgimisë së kulturës italiane e botërore. Ernest Koliqi, qysh herët, kur shkollohej në Itali, u njoh me një kulturë të gjerë sidomos latino-italiane, prej së cilës mori e dha.

Çdo gjuhë e botës duhet t'i ketë fjalët përkëdhelëse, të ngrohta, të buta. Këto njësi gjuhësore zgjedhen nga folësi në raste të veçanta dhe për persona të veçantë. Përmes këtyre fjalëve ne mundohemi ta shprehim dashurinë apo respektin ndaj dikujt. Gjuha shqipe flitet në treva të ndryshme, ka ndarje dialektore dhe sigurisht që pasuria leksikore është jo e njëjtë me njërin a tjetrin dialekt.

Koliqi, si një mjeshtër i shkrimeve në prozë, nuk e kapërcen këtë fond fjalësh, mirëpo e bën pjesë të veprës së tij. Një shembull më i qartë ku i gjejmë të përdorura këto fjalë është novela *Dram i vogël te Tregtar flamujsh*.

Si përfundim në lidhje me figurën dhe veprën e Ernest Koliqit në kuadër të fushës së etnolinguistikës, kemi marrë në shqyrtim dy veprat e tij si: *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*, të cilat sjellin në mënyrë shumë origjinale vlerat kulturore e ato gjuhësore të shqiptarëve. Secila prej këtyre novelave mbart një ngjarje nga bota fshatareske a qytetare e shqiptarëve dhe Shqipërisë. Lexuesi arrin lehtësisht që të ambientohet me mjedisin e rrëfimit të Koliqit dhe me personazhet që duken sikur t'i kishim parë apo takuar diku, personazhe aq reale dhe të gjalla njëhorësisht. Këto elemnete e identifikojnë në mënyrë besnike një popull, por dëshmojnë për vjetërsinë e tij, pasurinë, moralet, traditat e zakonet. Veprat e Koliqit mbeten forma unike të natyrës që kanë, me ato autori mori titullin e një krijuesi letrar të dalluar në prozën shqipe.

---

<sup>105</sup> Mimoza Priku, *Gjuha dhe kultura në vështrim etnolinguistik*, në: „Malësia“, nr. 7, revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore, Podgoricë, 2012, f. 183.

## BIBLIOGRAFIA:

- Bashota, Sali, *Domethënia e ideve letrare*, Rilindja, Prishtinë, 2001.
- Berisha Nikë Anton, *Koliqi dhe prozator*, Toena, Tiranë, 1997.
- Elsie, Robert, *Histori e letërsisë shqiptare*, përkthyes: Abdurrahim Myftiu, Dukagjini, Botimi i dytë, Pejë, 2001.
- Elsie, Robert, *Letërsia shqipe*, Tiranë, 2006.
- Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Kuvendi, 2001.
- Hamiti, Sabri, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2000.
- Hamiti, Sabri, *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003.
- Hoxha, Arben, *Poetika e prozës së Ernest Koliqit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005.
- Hoxha, Arben, *Poetika e prozës së Ernest Koliqit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005.
- Hoxha, Fatbardha, *Rreth kontributit të Ernest Koliqit si studiues i letërsisë*, në: "Studime Shqiptare", nr.3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995.
- Hoxha, Fatbardha, *Vështrim mbi mendimin letrar të Ernest Koliqit*, në: "Studime për autorë të ndaluar", Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2008.
- Karamitri, Eli, *Ernest Koliqi dhe arsimit shqiptar*, në: "Studime Shqiptare", nr. 3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995.
- Koliqi, Ernest, *Ese të letërsisë shqipe*, Botimet IDK, Kumi, 2005.
- Koliqi, Ernest, *Hija e maleve*, Buzuku, Prishtinë, 2003.
- Koliqi, Ernest, *Tregtar flamujsh*, Buzuku, Prishtinë, 2003.
- Koliqi, Ernest, *Vepra 2*, Konica, Prishtinë, 2003.
- Koliqi, Hajrullah, *Ernest Koliqi-ministër i arsimit kombëtar në Shqipërinë "Ethnike"*, në: "Malësia", nr. 7, revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore, Podgoricë, 2012.
- Krasniqi, Nysret, *Autori në letërsi*, AIKD, Prishtinë, 2009.
- Memisha, Valter, *Studime për fjalën shqipe II*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2015.
- Priku, Mimoza, *Gjuha dhe kultura në vështrim etnolinguistik*, në: "Malësia", nr. 7, revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore, Podgoricë, 2012.
- Rrokaj, Shezair, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë, 2009.
- Shkrutaj, Gjovalin, *Kundrime gjuhësore*, Tiranë, 2006.
- Shkurtaç, Gjovalin, *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2010.

Valentini, Zef, *Ernesti pasqyrë e kalimit njerëzor*, në: “Studime Shqiptare”, nr. 3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995.